



RAPORTI VJETOR

2024



www.kosovotelecom.com

Prishtinë, Mars 2025



RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2024

Telekom i Kosovës Sh.A.
Kosovo Telecom J.S.C.
Telekom e Kosovës D.D.
Nr./No./Nr. 01-1584/25
Data/Date/Datum 18-03-25
PRISHTINË, PRISTINA, PRIŠTINA

VENDIM

Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës miratoi Raportin Vjetor të TK Sh.A. për vitin 2024 në mbledhjen me nr. 09 të mbajtur me datë: 18.03.2025



Delegoi

Burbuqe Hana

Kryeshefe Ekzekutive – Telekom i Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

18.03.2025

Aprovoi

Petrit Nahi

Kryesues i Bordit të Drejtorëve - Telekom i Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

18.03.2025



I.	Lista e Tabelave.....	2
II.	Lista e Grafikëve /Figurave.....	3
III.	Shkurtesat	4
IV.	PROFILI I SHKURTËR I KOMPANISË	5
V.	RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	6
A.	· TË DHËNAT PËR DREJTORËT JOEKZEKUTIVË	8
VI.	FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS.....	9
VII.	RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE.....	10
A.	NGJARJET KRYESORE TË VITIT	12
B.	PASQYRAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKIMEVE NË KOSOVË	14
C.	PASQYRA E PERFORMANCES OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCES.....	17
D.	PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE DHE REZULTATET 2024	18
E.	PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT	19
F.	SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET	20
G.	PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN	21
H.	KALENDARI FINANCIAR	22
VIII.	Shtojca.....	23
A.	STATUTI I TK-SË	23
B.	PASQYRAT FINANCIARE PRELIMINARE PËR VITIN 2024	23
C.	SPONSORIZIMET DHE DONACIONET	23
i.	Pasqyrat e strukturës organizative	24
ii.	Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare gjatë vitit 2024	25
iii.	Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënua, ose që mund të përfshijnë korporatën.....	26
iv.	Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse	28

I. Lista e Tabelave

<i>Tabela 1. Numri i takimeve të Bordit</i>	<i>8</i>
<i>Tabela 2. Komitetet e Bordit.....</i>	<i>8</i>
<i>Tabela 3. Numrat aktiv të Vala.....</i>	<i>17</i>
<i>Tabela 4. Transaksionet e konsiderueshme</i>	<i>31</i>

II. Lista e Grafikëve /Figurave

<i>Figura 1 Proporcion i të hyrave të përgjithshme i paraqitur në përqindje (%)</i>	19
<i>Figura 2 Rezultati i performancës financiare në vitin 2024</i>	19
<i>Figura 3 Rezultatet e përformancës financiare - krahasimi me vitet paraprak</i>	20
<i>Figura 4 Struktura e re organizative</i>	24

III. Shkurtesat

- TK - Telekomi i Kosovës
- AB- Auditori i Brendshëm
- ZKA- Zyra kombëtare e Auditimit
- QoS – Kualiteti i shërbimeve (Quality of Services)
- BTS – Base transmission station - Stacion bazë
- NGN – (NextGenerationNetwork) = rrjetat e gjeneratës së re
- EWSD- Electronic Worldwide Switch Digital
- ITU - International Telecommunication Union (ITU) – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
- ETS- Emergency Telecommunications Service - Shërbimi Emergjent i Telekomunikacionit
- IPTV- Internet Protocol Television -Televizion përmes protokollit të internetit
- POSTPAID- Konsumatorët me faturë mujore
- PREPAID - Konsumatorët me parapagim
- SMS- Shërbimi i mesazheve me tekst
- ARPU- Të ardhurat mesatare për konsumator
- OTT- Over the Top (aplikacione për biseda, chat dhe mediatike online)
- OE- Operator Ekonomik
- LTE- Long Term Evolution – Standard i evolucionit afatgjatë
- IP- Internet Protocol (Protokolli i Internetit)
- MTI- Telekomi i Monakos, pjesa ndërkombëtare
- CC377 e MCC212.
- SOP- Procedurë Standarde të Operimit
- 2G- Gjenerata e dytë e komunikimeve mobile
- 3G – Gjenerata e tretë e komunikimeve mobile
- 4G- Gjenerata e katërt e komunikimeve mobile
- GSM - Global System For Mobile Communication (Sistemi Global për Komunikim Mobil)
- GPRS-GENERAL PACKET RADIO SERVICE) = Platforma për shërbimin e Internetit
- EBITDA- Earning Before Interest Tax Depreciation and Amortization/ Fitimi para tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit
- CAPEX- Investimet Kapitale
- ISP - Internet Service Provider (Ofrues i shërbimit të internetit)
- ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

IV. PROFILI I SHKURTËR I KOMPANISË

Telekomi i Kosovës (TK) është një kompani publike që operon në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Si lider në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të komunikimeve elektronike në vend, Telekomi i Kosovës Sh.A synon të udhëheqë zhvillimin e këtij sektori, duke ofruar një portofol të gjërë shërbimesh në telefoninë mobile, atë fikse dhe përbajtje televizive, me fokus në plotësimin e nevojave dhe pritshmërive të klientëve.

Për periudhën 2024-2026, prioritet mbetet forcimi i stabilitetit finansiar, i cili do të arrihet përmes zhvillimit të aktiviteteve në përputhje me strategjinë afatgjatë dhe kërkesat e konsumatorëve për produkte dhe shërbime cilësore.

Si një shtyllë kryesore në industrinë e komunikimeve elektronike në Kosovë, Telekomi i Kosovës është i angazhuar të shndërrohet nga një kompani e fokusuar kryesisht në shërbimet e zërit, në një ofrues të avancuar të shërbimeve të të dhënave (internet) me shpejtësi ultra të lartë, duke mundësuar qasje në teknologjitet më të reja për të gjithë konsumatorët.

Në një kohë të globalizimit dhe përparimeve të vazhdueshme teknologjike, Telekomi i Kosovës investon në inovacion dhe shfrytëzon çdo mundësi të re teknologjike për të sjellë produkte dhe shërbime moderne, të përshtatura me kërkesat dhe nevojat e përdoruesve.

V. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Inderuari Aksionar,

Po ju drejtohem në cilësinë e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës për të prezantuar Raportin Vjetor të Telekomit të Kosovës Sh.A, të përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Fillimisht, Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës u emërua nga Qeveria e Kosovës më 24.07.2024 dhe ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sikurse është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 (në vijim referuar si Ligji për Ndërmarrjet Publike). Gjatë kësaj periudhe, Bordi i Drejtorëve ka punuar në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe ka siguruar zbatimin e detyrave fiduciare të qeverisjes korporative. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti janë angazhuar për të zhvilluar dhe transformuar korporatën, duke pasur në fokus përmirësimin e shërbimeve dhe produkteve për klientët tanë, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të Telekomit.

Me shumë kënaqësi mund të them se gjatë vitit 2024, Telekomi i Kosovës ka arritur të realizojë objektivat kryesore, duke treguar përshtatshmëri në një mjedis dinamik dhe sfidues të biznesit, ndërkokë që proceset e trashëguara nga e kaluara kanë qenë një sfidë e vazhdueshme.

Gjatë këtij viti, Telekomi ka finalizuar modernizimin teknologjik të rrjetit mobil, duke përfshirë prezantimin dhe ofrimin e teknologjisë më të re 5G – një arritje kyçë për të siguruar konkurrencën në treg dhe vijueshmërinë e ofrimit të shërbimeve në të ardhmen, bazuar në teknologjinë më të re të rrjeteve mobile. Në të njëjtën periudhë, Telekomi ka nisur procesin e modernizimit të rrjetit optik dhe të shërbimeve fiksë me brez të gjerë, që përbën një tjetër objektiv strategjik me rëndësi kritike për qëndrueshmërinë e ndërmarrjes në të ardhmen.

Gjendja financiare e Telekomit të Kosovës vazhdon të mbetet sfiduese për shkak të pasojave negative të kontratave të dëmshme të trashëguara nga e kaluara. Megjithatë, Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti kanë vazhduar me kujdes dhe përkushtim adresimin dhe trajtimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme, përfshirë edhe ato emergjente.

Telekomi i Kosovës ka disa procese të hapura gjyqësore, dhe Bordi, në vazhdimësi, ka përkrahur dhe udhëzuar Menaxhmentin Ekzekutiv që të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura procedurale për të siguruar një përfaqësim dhe mbrojtje dinjitoze të ndërmarrjes.

Procesi i ristrukturimit të korporatës ka qenë një nga angazhimet kryesore të Bordit dhe Menaxhmentit gjatë këtij viti. Me shumë sinqeritet mund të them se Bordi i Drejtorëve, bazuar në profesionalizëm dhe transparencë të plotë, ka arritur të shqyrtojë dhe miratojë rekomandimet e Komisionit për Ristrukturim dhe Komisionit për Përshkrimin e Vendeve të Punës dhe Gradimet, duke përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në skemën e aprovuar.

Ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me klientët është fokusi ynë kryesor dhe mbetet gurthemeli i filozofisë sonë të biznesit. Raportet për matjen e kënaqshmërisë së klientëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve dhe produkteve kanë rezultuar pozitive, veçanërisht pas finalizimit të modernizimit të rrjetit, gjë që konsiderojmë se kontribuon në rritjen e besnikërisë së klientëve ndaj Telekomit të Kosovës.

Përgjegjësia sociale dhe qëndrueshmëria mbeten prioritete të rëndësishme për Bordin, dhe do të vazhdojmë të mbështesim aktivitetet që përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitetin që shërbejmë.

Pavarësisht sfidave, Telekomi i Kosovës ka arritur një performancë të qëndrueshme financiare gjatë vitit 2024, duke realizuar një EBITDA pozitive prej 13,476k € dhe një fitim neto prej 6,808k €, tejkalim i planit të biznesit për këtë vit.

Telekomi i Kosovës ka nisur rrugëtimin e tij drejt rimëkëmbjes dhe me bindje të plotë mund të them se duhet të vazhdojë të fuqizojë fryshtën e punës dhe vlerat e tij për të rikthyer plotësisht qëndrueshmërinë, duke mbështetur inovacionin, transparencën dhe profesionalizmin në ambientin e biznesit.


Krejt në fund, në emër të Bordit të Drejtorëve, dëshiroj të shpreh falenderim për punën e Menaxhmentit Ekzekutiv, angazhimin e punonjësve të përkushtuar, si dhe për besnikërinë e klientëve tanë.

Sinqerisht,

– Kryesues i Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A.

a. Të dhënat për drejtorët joekzekutivë

Struktura paraqet emrat e drejtorëve joekzekutivë, zyrtarin kryesor të korporatës dhe sekretarin e korporatës/këshilltarin e përgjithshëm të korporatës.



Bordi i Drejtoreve TK Sh.A. i emëruar me Vendim të Qeverisë nr. 04/214 më dt. 24.07.2024¹

Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore (në këtë rast Telekomi Kosovës Sh.A.) bëhet sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.07/81, datë: 23.03.2016.

Numri i takimeve të bordit gjatë vitit dhe numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e BtD

Takimet e bordit	Numri i takimeve	Numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takime të bordit
Takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve	13	<ul style="list-style-type: none"> Kryesuesi 3 Drejtorët e Bordit Kryeshefja Ekzekutive dhe Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretari i Korporatës

Tabela 1. Numri i takimeve të Bordit

Komititetet e bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Komiteti i Auditimit ²	12	<ul style="list-style-type: none"> Sajmie Thaci, Kryesuese Rezarta Pllana, Anëtare Lindita Toçi, Anëtare Kujtim Saraçi, Auditor i Brendshëm Shekip Fazliu, Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretar i Korporatës
-----------------------------------	----	--

Tabela 2. Komitetet e Bordit

Sinqerisht,

Petrif Nahi – Kryesues i Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A

¹ Bordi i ri i Drejtorëve të TK Sh.A është emëruar me Vendim të Qeverisë nr.04/2024 më 24.07.2024, pas skadimit të mandatit trevjeçar të Bordit të Drejtorëve paraprak të emëruar me Vendim të Qeverisë nr.02/08 dt.21.04.2021

² Komisioni i ri i Auditimit është emëruar me Vendim të Ministrisë së Ekonomisë nr.01/5202 më. 29.07.2024 pas skadimit të mandatit trevjeçar të Komisionit të Auditimit paraprak emëruar me vendim të Ministrisë së Ekonomisë nr. 01/1147 dt.30.04.2021.

VI. FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS

VITI I KËNDELLJES: FINALIZIMI I PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË RRJETIT MOBIL DHE FILLIMI I PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË RRJETIT FIKS

Përderisa viti 2023 ishte vit i inicimit dhe përkushtimit serioz në implementimin e projekteve të shumta në rrjetin mobil, viti 2024 ishte vit i finalizimit të modernizimit teknologjik të rrjetit mobil, prezantimit dhe ofrimit të teknologjisë inovative 5G, si dhe vit i fillimit të modernizimit të rrjetit optik dhe shërbimeve fiksë brezgjëra.

Si rezultat i modernizimit të plotë të rrjetit mobil Vala me teknologjinë më të re, investimet teknologjike në këtë vit u vunë në shërbim të plotë të konsumatorëve, duke rritur në një nivel të lartë cilësinë e shërbimeve të zërit dhe të internetit në rrjetin mobil.

Paralelisht këtyre investimeve, Telekomi i Kosovës, në fund të këtij viti, ka nënshkruar edhe kontratat që kanë të bëjnë me implementimin e projektit madhor të modernizimit të rrjetit fiks "Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese në tërë territorin e Kosovës", për të përmbyllur kështu në nivel strategjik modernizimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të sigurta të të dy rrjeteve të veta telekomunikuese, si të rrjetit mobil ashtu edhe atij fiks.

Në rrugëtimin e rimëkëmbjes së korporatës, edhe viti 2024 sikurse 2023 ishte vit i operimit pozitiv financiar. Telekomi i Kosovës Sh.A në vitin 2024 mbylli pasqyrat e veta financiare me fitim pas tatimit në vlerë prej 6,808 k euro (afér 7 milionë euro).

Me vigjilencë të jashtëzakonshme për shpenzimet operative dhe me kujdes maksimal për menaxhimin e parasë publike përfundimisht, me vitin 2024, nga periudha e mbijetesës, po kalojmë në një periudhë të këndelljes dhe ngritjes jo vetëm të shërbimeve telekomunikuese por edhe të performancës së përgjithshme të kompanisë.

Gjatë këtij viti jemi përballur dhe vazhdojmë të përballemi ende me sfidat e pasojave negative të kontratave të dëmshme nga e kaluara. Me një punë sistemore dhe konsistente ligjore, kemi arritur të sigurojmë që pesha e borxheve nga këto kontrata korruptive të së kaluarës, që kanë vazhduar të ekzekutohen edhe këtë vit nga përmbaruesit privatë, të mos e bllokojë apo rrënojë kompaninë. Në këto aktivitete, kemi vazhduar që të angazhojmë të gjitha kapacitetet profesionale ligjore në dispozicion, për të realizuar strategjinë e përcaktuar në mbrojtje të interesave të kompanisë, që konsiston në identifikimin e opsjoneve ligjore, dokumentimin e të gjitha detajeve relevante të sakta dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve konkrete të lejuara me ligjet në fuqi.

Edhe përkundër që ndërmarrja brenda vittit operoi rreth 6 muaj me llogari të bllokuara, si korporatë arritëm të realizojmë zgjidhje të ligjshme për të shlyer në kohë shumicën dërmuese të obligimeve rrjedhëse ndaj operatorëve ekonomikë, në afatet e arritura për pagesë, duke ruajtur dhe siguruar kështu besueshmërinë e partnerëve të biznesit.

Zhvillimi dhe ligjshmëria vazhdojnë të janë udhërrëfyesit e veprimtarisë së ndërmarrjes, ndërsa raportimi transparent dhe i saktë para publikut, Bordit të Drejtoreve, Aksionarit dhe të gjitha agjencive shtetërore si dhe mediave, mbetet pjesë e pandashme e kësaj veprimtarie.

Sinqerisht,

Burbuqe Hana- Kryeshefe Ekzekutive e TK Sh.A

VII. RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE

Përkundër vështirësive logjistike dhe teknike të paraqitura gjatë implementimit të modernizimit të platformave dhe të rrjetit mobil, Plani i Biznesit është realizuar në plotni. Viti 2024 ishte vit i vazhdimit të sukseseve dhe orientimit të Telekomit të Kosovës në realizimin e projekteve kapitale për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në drejtim të një rrjeti të integruar telekomunikues. Kjo infrastrukturë telekomunikuese zgjeron mundësi për ofrim të portfolios së shërbimeve konvergjente për të plotësuar nevojat aktuale dhe ato në rritje të konsumatorëve.

Krahas aktiviteteve të tjera të shumta, procesi i filluar i ristrukturimit të korporatës u zhvillua me konsistencë të plotë. Kompania e mbylli vitin me gjithsej 1706 punëtorë (49 punëtorë më pak se viti paraprak). Gjatë periudhës raportuese të vitit 2024 janë shpallur gjithsej 136 konkurse të brendshme dhe një konkurs i jashtëm, në respektim të plotë të Rregulloreve dhe Ligjit përkatës në fuqi. Rritja e efektivitetit të strukturës së re ka vazhduar me trajnimin e stafit, ku gjatë kësaj periudhe, 5 shtyllat e Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim kanë ofruar gjithsej 5,252 orë trajnimi për 802 punonjës të Telekomit të Kosovës.

Në funksion të përmirësimit të përvjës se përgjithshme të konsumatorëve, janë realizuar 10 hulumtime, ndër to edhe hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet tona mobile. Nga ky hulumtim ka rezultuar se kemi një ngritje të theksuar të lojalitetit të konsumatorëve, me një "Net Promoter Score" të lartë, prej 52.34. Krahas kujdesit të përmirësuar për konsumatorët që ofrohet në Qendrën e Thirrjes dhe pikat tona të shitjes, është rritur përdorimi i aplikacionit të vetëkujdesit 'Vala jone' në 150K përdorues aktiv. Për të qenë më afér konsumatorit janë hapur tri pika të reja shitjeje, që kanë kontribuar në rritjen e përgjithshme të pagesave në pikat tona të shitjes për rrëth 11%, krahasuar me vitin paraprak. Përmirësimi i gamës dhe cilësisë së produkteve me pakon të reja dhe përbajtje të shtuar të internetit dhe televizionit (TV Vala) është shoqëruar me implementimin e teknologjisë OTT, ofrimin e eSIM, avancimin e të gjitha pakove mobile Prepaid dhe Postpaid, dhe me kampanjë të veçantë verore dedikuar mërgatës sonë.

Në këtë kuadër, kompania ka njoftuar publikun e jashtëm dhe të brendshëm për ndryshimet, duke ndjekur dinamikën e tyre, qoftë përmes njoftimeve, konferencave për media, apo përmes mediave sociale dhe atyre të brendshme të kompanisë. Edhe përkundër qasjes dhe gjuhës tendencioze të disa mediave kemi mbajtur marrëdhënie korrekte të bashkëpunimit me media dhe publikun, duke mos lënë asnjë rast pa përgjigje. Në vitin 2024, kemi pranuar dhe kthyer 87 përgjigje të kompletuara për mediat, me disa pyetje secila, që përfshinë më shumë se 300 pyetje, për të cilat, në bashkëpunim me njësitet përkatëse, janë siguruar përgjigje të shpejta, të plota dhe të sakta. Qëllimi ynë mbetet profesionalizmi dhe shërbimi ndaj publikut të gjërë 24/7, duke përbushur kështu obligimin tonë ligjor dhe moral si kompani publike.

Përpos përgjigjeve të dhëna mediave gjatë vitit raportues kemi mbuluar në kohë të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, kemi bashkëpunuar në dorëzimin e dokumenteve sipas kërkesave në ZKA, NJPMNP, IP, APK, ARKEP e Prokurori, kemi përpiluar në afatet e parapara raportet tremujore, vjetore, regjistrimin e mjeteve themelore, pasqyrat financiare, kemi përpiluar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2025, etj.

Përfaqësimet në gjykata të rregullta dhe procedurat përbërimore janë realizuar në afatet optimale dhe nuk ka pasur asnjë mungesë të përfaqësimit të interesave të korporatës në gjykata. Gjatë vitit 2024, Departamenti Ligjor i Telekomit të Kosovës Sh.A, ka pasur në punë aktive gjithsej 921 lëndë gjyqësore të natyrave të ndryshme.

Me një buxhet modest, Telekomi i Kosovës ka organizuar aktivitete mbështetëse për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë në kuadër të përgjegjësisë sociale korporative.

Në kuadër të Departamentit të Logistikës dhe sektorit të operatives janë përmbushur me sukses të gjitha kërkosat dhe aktivitetet e planifikuara dhe të paplanifikuara nga departamentet, rajonet, komunat, objektet dhe pikat e shitjes. Gjithashtu, është vepruar sipas nevojave dhe urgjencave në fusha si siguria, monitorimi elektronik, depot, mirëmbajtja, transporti, energjetika, ngrohja dhe klimatizimi, kontrolli dhe transporti i parasë (CIT).

Ndaras vështirësive të shumta logjistike për shkak të mungesës dhe yjetërsisë së automjeteve, moshës mesatare të lartë të personelit, buxhetit dhe mundësive të kufizuar përballë nevojave të shumta operative dhe investive, me punë dhe përkushtim të pandalur të shumicës së punëtorëve të motivuar, Telekomi ngadalë, por sigurt, po këndellet nga "vdekja klinike" e katandisur vite me radhë. Shfrytëzoj këtë rast që të veçoj angazhimin maksimal dhe profesional të menaxhmentit ekzekutiv dhe atij të lartë të Telekomit, me të cilët çdo sfidë përgjatë vitit u kthye në mundësi dhe zgjidhje konstruktive për korporatën. Ju faleminderit.

Në vijim të këtij reporti, janë ofruar informata për:

- a) ngjarjet kryesore të vitit,
- b) pasqyrën e tregut të telekomunikimeve në Kosovë,
- c) pasqyrën e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës,
- d) performancën financiare,
- e) progresin me planin e biznesit,
- f) shpenzimet kapitale dhe projektet,
- g) perspektivën për të ardhmen,
- h) Kalendarin financiar

a. Ngjarjet kryesore të vitit

Viti 2024 karakterizohet si një periudhë dinamike dhe e suksesshme për Telekomin e Kosovës, me arritje të rëndësishme në fushën e inovacionit teknologjik, marketingut, shitjes dhe përgjegjësisë sociale. Përmes hulumtimeve të tregut, fushatave promocionale dhe investimeve në modernizimin e rrjetit, kompania ka përmirësuar ndjeshëm përvojën e klientëve dhe ka rritur bazën e përdoruesve. Po ashtu, angazhimi në projekte strategjike dhe bashkëpunime të reja ka kontribuar në forcimin e pozitës së Telekomit në tregun e telekomunikacionit në Kosovë.

Të arriturat kryesore dhe zhvillimet e vitit:

- **Investime në rrjet** – Finalizimi i modernizimit të rrjetit me teknologji 4G+ dhe 5G. Inicializimi i projektit madhor të modernizimit me rrjet optik në tërë territorin e vendit.
- **Performancë financiare pozitive** – Rritje e ndjeshme e të hyrave, numrit të klientëve dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare.
- **Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve** – Lansimi i TV Vala OTT, shërbimi eSIM për Postpaid dhe Prepaid, si dhe paketa të reja për Diasporën.
- **Fushata të suksesshme marketingu** – Përfshirë kampanjat "Diaspora Jonë & Diaspora Plus" dhe promovimet e pakove të reja.
- **Përmirësimi i shërbimit ndaj klientit** – Rritje e efikasitetit në Qendrën e Thirrjeve dhe shtim i kanaleve digitale të komunikimit.
- **Pjesëmarrje në projekte sociale** – Donacione, fushatadhe mbështetje për komunitetet në nevojë.
- **Zgjerimi i rrjetit të shitjes** – Hapja e tri pikave të reja në Fushë Kosovë, Albi Mall dhe Mitrovicë Veriore, si dhe ribrendimi i disa pikave ekzistuese.

Për një pasqyrë më të detajuar mbi aktivitetet dhe arritjet gjatë vitit, në sektionet në vijim mund të gjeni një pëershkrim më të detajuar të veprimtarive të drejtive. Secila drejtori ka luajtur një rol kyç në realizimin e objektivave strategjike, duke kontribuar në rritjen e shërbimeve, përmirësimin e përvojës së klientëve dhe forcimin e pozitës së Telekomit të Kosovës në treg.

Marketing, Shitje dhe Kujdesi për Konsumatorë

Kjo drejtori ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe aktivitetesh duke kontribuar kështu në ndikimin pozitiv në përvojën e konsumatorëve përmes ofertave dhe qasjes direkte apo indirekte të kujdesit si dhe duke ndihmuar në arritjen e objektivit të rritjes së të hyrave për Telekomin e Kosovës.

1. Hulumtime dhe Analiza

Viti 2024 ka qenë i mbushur me hulumtime të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të Telekomit të Kosovës. Disa nga hulumtimet kryesore përfshijnë:

- Analiza Konkuruese, Sim Diaspora, Preferencat e Studentëve, Dëgjueshmëria e Radiove, Performanca e Rrjetit, Kënaqshmëria e Konsumatorëve, Promovimi i Pikës së Re Vala, Pika e Shitjes në Prishtina Mall, Efikasiteti në Qendrën e Thirrjeve.

2. Kampanja Promocionale:

- TV Vala OTT dhe eSIM, Diaspora Jonë & Diaspora Plus, Modernizimi i Rrjetit Vala (4G+ dhe 5G), Pako të Reja Prepaid dhe Postpaid..

3. Ofertat Promocionale – Pakot Prepaid:

- Fito 5GB Ekstra, Fito 5GB Internet 5 Ditë.

4. Projekte Strategjike

- **Google Maps:** Listimi dhe përditësimi i pikave të shitjes së VALA përmes platformave zyrtare dhe rritja e dukshmërisë në platformat e Google..

5. Projekte dhe Ngjarje për Përgjegjësi Sociale:

Telekomi i Kosovës ka vazhduar angazhimin e tij në komunitet, duke realizuar projekte sociale si:

- Vala kundër Dhunës, Fëmijët Festojnë me Vala, Tetori Rozë, Vala për të Moshuarit, Takimi Vjetor i Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ) në Prishtinë:

6. Lansimi/modifikimi i pakove/shërbimeve

Disa nga shërbimet e reja të lansuara gjatë vitit përshijnë:

- Pako të kombinuara: Internet, TV dhe telefon fiks përmes OTT (TV Vala), eSIM për Postpaid dhe Prepaid, Data Roaming, mujore për Evropë, Internet i Dedikuar (ProOn), Pako & numër i ri Diaspora përmes SIM & eSIM, Pako SIP/LTK me numra shtesë me pagesë në kuadër të shërbimit, Pako e kombinuar Prepaid për përdorim në WB6, REG dhe EU

Modifikimi i pakove/shërbimeve ekzistuese:

- Largimi i shërbimit FnF (familja dhe miqtë) për të gjithë numrat Prepaid, Pakot e stafit të Telekomit (S1 dhe S2) për përdorim edhe në WB6 & Rajon, Pakot Postpaid nga 1 tetor 2024, Pakot e kombinuara Prepaid nga 1 nëntor 2024, Tarifa "Pay as you go" për data home në Postpaid, Formë e re për blerjen e pakove përmes USSD

Aktivitete të tjera të produkteve:

- Marrëveshje e re 3-vjeçare për përmbajtjen TRING, Marrëveshje për përmbajtje të re me DigitALB, Promocione të pakove të kombinuara Prepaid përmes Vala jonë dhe kanaleve të tjera të shitjes.

Zhvillime të Rëndësishme në Shitje dhe Promocion

- **Vazhdimi i kontratave të qirasë:** vazhdimi i kontratave për gjashtë pika shitjeje në Prizren, Pejë, Ferizaj, Aeroportin e Prishtinës dhe Prishtina Mall.
- **Ri-brendimi i pikave të shitjes:** Përmirësimi i gjashtë pikave kryesore për rritjen e vizibilitetit dhe kushteve të punës, me procesin në vazhdim në regjione të tjera.
- **Instalimi i POS terminaleve:** Përfundimi i instalimit të terminaleve për pagesa me kartelë në të gjitha pikat e shitjes, në bashkëpunim me Bankën Ekonomike.

Çështje të Korporatës

Në kuadër të komponentës ligjore janë ndërmarrë veprime për konsolidimin e departamentit dhe njësive përkatëse me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore në mënyrë efikase dhe të duhur. Njëherësh janë ndërmarrë edhe disa veprime ligjore, janë iniciuar padi në gjykata të rasteve të kontratave që përmbajnë problematika të zbatimit të dispozitave të caktuara.

Gjatë vitit 2024, Qendra për Trajnim dhe Zhvillim (QTZH) në Telekomin e Kosovës ka realizuar plane dhe kërkesa për trajnime nga departamentet e ndryshme, duke përfshirë pesë shtylla kryesore: ASHKKM, TI, NP, Gjuha Angleze (GJA), dhe MP.

Në total, QTZH ka ofruar 5,252 orë trajnimi për 802 punonjës të Telekomit të Kosovës. Ndër të tjera, QTZH ka zhvilluar takim me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve për akreditimin e shtyllës së Gjuhës Angleze, ka marrë pjesë në konferencën për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të organizuar nga ILO, GJA dhe zyrtarë të tjera morën pjesë në trajnimin për platformën e regjistrat të kualifikimeve të Kosovës, si dhe ka qenë nikoqire për trajnime dhe takime të ndryshme, përfshirë trajnimin për E-sim, pajisjet testuese të rrjetit mobil etj..

Në kuadër të Departamentit të Logistikës, pavarësisht vështirësive, janë përmbushur me sukses të gjitha kërkesat dhe aktivitetet e planifikuar dhe të paplanifikuar nga departamentet, rajonet, komunat, objektet dhe pikat e shitjes.

Gjatë vitit 2024, sektori operativ ka siguruar funksionimin e pandërprerë të transportit, depos, sigurisë dhe mirëmbajtjes. Në sektorin e transportit, janë kryer me sukses mirëmbajtjet e automjeteve, duke reduktuar konsumin e derivateve me 12.36% dhe distancën e përshkuar me 7.42%. Në depo, zinxhiri i furnizimit ka funksionuar pa probleme, si dhe me implementimin pa pengesa të projektit 400 BTS.

Sektori i sigurisë ka zbatuar kontolle rigorozë mbi prezencën e stafit, kursimin e energjisë dhe hyrje-daljet, duke rritur masat e sigurisë për stafin dhe asetet. Në mirëmbajtjen e objekteve, janë realizuar riparime dhe optimizim i shpenzimeve, përfshirë kontrata për pastrim dhe mirëmbajtje teknike, si dhe servisimi i pajisjeve kundër zjarrit. Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë masa për optimizimin e burimeve, përmirësimin e infrastrukturës dhe forcimin e sigurisë, duke përfshirë rregullore të reja për përdorimin e automjeteve dhe qasjen në objekte, si dhe investime në sistemet e alarmit dhe mbrojtjen kundër zjarrit

b. Pasqyrat e Tregut të Telekomunikimeve në Kosovë

Tregu i telekomunikimeve, duke përfshirë shërbimet dhe produktet e tij, është dinamik dhe në ndryshim të vazhdueshëm në mbarë botën. Ky ndryshim vjen si rezultat i inovacioneve në teknologji, produkte dhe shërbime, si dhe aktivitetave të tjera që fokusohen në digitalizim. E njëjtë dinamikë vërehet edhe në Kosovë, e nxitur nga risitë teknologjike, ndryshimet në sjelljen e konsumatorëve dhe digitalizimi i shërbimeve administrative dhe financiare.

Performanca e Tregut të Telekomunikacionit

Sektori i telekomunikacionit në Kosovë ka shënuar një rritje të qëndrueshme gjatë vitit 2024, me të hyra të pritura prej 173¹ milionë euro (+2% krahasuar me 2023). Struktura e të hyrave:

- **Telefonia Mobile** (72% e totalit) ka shënuar një rritje prej mbi 6%.
- **Internet Fiks** (26.5% e totalit) ka pësuar rënje prej 2%.
- **Linjat me Qira** përbëjnë 0.5% të të hyrave, pa ndryshime të mëdha.
- **Telefonia Fiks** ka vazhduar të bie (-34% në 2024 krahasuar me -26% në 2023).

Investimet dhe Strukturimi i Tregut

Investimet nga operatorët ranë nga 56 milionë euro në 2023 në mbi 38 milionë euro në 2024. Fokusi kryesor i investimeve ishte përmirësimi i rrjeteve mobile dhe internetit fiks. Telekomi i Kosovës (Vala) dhe IPKO vazhdojnë të mbajnë 95% të tregut të telefonisë mobile.

Struktura e Ofruesve të Shërbimeve

- **Rrjetet Mobile:** 3 operatorë kryesorë (Telekomi i Kosovës, IPKO dhe MTS d.o.o.).
- **Rrjetet Fiks:** 99 ndërmarrje (+10 krahasuar me 2023).
- **Shërbimet e Internetit:** 90 ndërmarrje (+9 krahasuar me 2023).
- **Shërbimet me Vlerë të Shtuar (VAS):** 32 ndërmarrje (-3 nga 2023).

Shërbimet e Internetit Fiks dhe Përmbajtja Televizive

¹ Sqarim: Në mungesë të raportit të ARKEP për TM4 / 2024, është supozuar një mesatare e të hyrave gjatë vitit (2024) dhe gjatë TM4 të viteve paraprake

Tregu i internetit fiks në Kosovë është shumë konkurrues, me 402,284 linja aktive deri në TM3-2024. Megjithatë, ka mungesë raportimesh të sakta për të ardhurat nga operatorët e shpërndarjes së përbajtjeve televizive.

Roli i Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM)

KPM mbikëqyr operatorët televizivë dhe shpërndarjen e përbajtjeve. Deri në janar 2023, në Kosovë ishin të licencuar:

- 22 operatorë kabllorë
- 2 operatorë kabllorë + IPTV (Telekomi i Kosovës, Telkos)
- 2 operatorë OTT + IPTV (Telekomi i Kosovës, Artmotion)
- 3 operatorë vetëm OTT
- 4 operatorë vetëm IPTV

Numri i televizioneve të licencuara përmes këtyre operatorëve është 114¹.

Tendencat e Përdoruesve dhe Nevoja për Investime

Tregu i telefonisë mobile vazhdon të rritet me mbi 2 milionë përdorues aktivë dhe një rritje prej 9.8% krahasuar me vitin e kaluar. Përdorimi i 4G/5G po rritet ndjeshëm, ndërsa teknologjia 3G është hequr nga përdorimi.

Investimet e Telekomit të Kosovës në vitet 2023-2024 janë përqendruar në modernizimin e rrjetit dhe kalimin nga kodi +377 në +383. Përmirësimi i cilësisë së rrjetit është thelbësor për mbajtjen dhe rritjen e bazës së klientëve.

Tregu i Shërbimeve Fikse dhe Internetit

- Përdorimi i telefonisë fikse është në rënje të vazhdueshme (-34% në 2024).
- Shërbimet e internetit fiks janë shtrirë në të gjithë Kosovën.
- Penetrimi i internetit fiks për ekonomi familjare është 135.4%, ndërsa sipas numrit të banorëve është 22.16%.
- Interneti fiks është kryesisht i kombinuar me shërbimet televizive.

Analizë e tregut sipas llojeve të shërbimeve: mobile, fikse dhe brezgjëra fikse

Tregu i Shërbimeve Mobile Tregu i telekomunikimeve në Kosovë dominohet nga shërbimet mobile, të cilat përbëjnë 72%² të të hyrave totale, duke arritur mbi 125 milionë euro në vit. Numri i përdoruesve kalon 2 milionë, me një rritje prej 9.8% në 2024. Rritja e përdorimit të 4G+ dhe 5G ka ndikuar në përmirësimin e shërbimeve të internetit.

Investimet dhe Infrastrukturat Investimet në telekomunikacion ranë nga 57 milionë euro në 2023 në 38 milionë euro në 2024. Telekomi i Kosovës ka filluar modernizimin e rrjetit dhe kalimin në kodin +383, por investimet tona mbeten nën nivelin e operatorëve konkurrues.

Tregu i Shërbimeve Fikse dhe Internetit Telefonia fikse është në rënje të vazhdueshme, me një tkurre të të hyrave prej 34% në 2024. Pjesëmarrja e saj në të ardhurat totale nuk kalon 1.32%.

Ndërkohë, interneti fiks është sektori më konkurrues, me 402,284 linja aktive dhe një penetratë prej 135.4% për ekonomitë familjare. Telekomi i Kosovës mban vetëm 7.2% të tregut, kryesisht për shkak të mungesës së investimeve në rrjetet optike dhe përbajtjen televizive konkurruese.

¹ Burimi: <https://www.kpm-ks.org/Page/138>

² Përllogaritur si raport mes të hyrave në shërbimet mobile karshi të hyrave të gjithmbarshme në industri. Burimi: raportet tremujore nga ARKEP për vitin 2024.

Tregu i shërbimeve të internetit me qasje fiksë, numri i linjave

Kosova është ndër vendet e para në rajon me qasje të plotë në internet fiks në çdo vendbanim. Ky sektor është shumë konkurruesh, me 90 operatorë aktivë dhe 402,284 linja brezgjëra deri në TM3-2024. Interneti fiks përbën rreth 27% të të hyrave totale të industrisë së telekomunikacionit, duke gjeneruar mbi 46 milionë euro në vit.

Modeli i Ofimit të Shërbimeve Për mbi 95% të rasteve, interneti fiks ofrohet në paketa të kombinuara me TV. Megjithatë, raportet mbi të hyrat nga shpërndarja e kanaleve TV mungojnë në raportet e ARKEP dhe KPM, duke mos reflektuar plotësisht ndikimin e këtij segmenti në treg.

c. Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

i. Shërbimet mobile

Infrastruktura e Telekomit të Kosovës lidhur me shërbimet mobile ofron mbulueshmëri: 2G në bazë të popullsisë në nivel vendi prej rrëth 99.8%, ndërsa mbulueshmëri të territorit 98.5%; 4G/4G+ në 98.5% të popullsisë dhe 94.5% të territorit; dhe, në 5G më mbulueshmëri të 72% të popullsisë dhe 45% të territorit (tabela më poshtë). Kurse, 5G me shpejtësi të lartë në brezin 3.6 GHz deri në fund të vitit 2024 mbulohet me 31% të popullsisë. Kapacitetet teknike të instaluarar për konsumatorët prepaid dhe postpaid janë 1.5 milionë. Infrastruktura teknologjike është GSM/GPRS/EDGE, 4G/4G+ dhe 5G.

Mbulueshmëria	2G	4G/4G+	5G
Popullsia	99.80%	98.50%	72.00%
Territori	98.50%	94.50%	45.00%

Rrjeti Radio gjatë vitit ka operuar nga pajisjet e tre prodhuesve, ish Alcatel-Lucent, Nokia, dhe Ericsson NT përmes projektit në implementim. Në fund të vitit, rrjeti Radio ka filluar të operojë vetëm nga pajisjet e Ericsson NT.

Aktualisht, shërbimet mobile të qasjes brezgjerë me teknologjinë 4G/4G+ janë duke u pritur shumë mirë nga konsumatorët tanë, shërbim i cili është shumë më konkurrues në krahasim me operatorët tjere. Teknologja e cila është duke u përdorur për këtë shërbim është pjesë e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe këto shërbime po ofrohen për bizneset, institucionet e ndryshme dhe konsumatorët individual në Kosovë.

Numri i konsumatorëve aktiv në fund të TM4 të vitit 2024 duke përfshirë edhe konsumatorët roaming ishte 889139.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vetëm numrat aktiv të Vala:

Në databazën e konsumatorëve (UDM)	prepaid dhe postpaid aktiv			
	2023	2024	2023	2024
2G		921,134	218,167	154,155
3G	897,448	998,686	143,622	132,414
4G	697,650	740,209	481,503	641,389
5G		57,545		20,885

Tabela 3. Numrat aktiv të Vala

Trendet e lëvizjes së numrit total të konsumatorëve aktiv në tri vitet e fundit nuk tregojnë për ndonjë lëvizje të theksuar, me përjashtim të periudhave kohore rrëth festave kur reflekton prezencia e shtuar e bashkatdhetarëve. Nga shifrat e cekura më lart vërehet rritje me tepër se dyfish e konsumatorëve aktiv 4G, dhe zvogëlim i konsiderueshëm i konsumatorëve 2G dhe 3G. 3G është ndërprerë si teknologji në fund të vitit.

Ky ndryshim e ka shpjegimin e vet logjik në faktin se me implementimin e projektit "Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil", teknologjia 4G/4G+ ka marrë rolin dominues në teknologjinë mobile të Telekomit të Kosovës.

Roaming

Mbulimi me roaming është zgjeruar me shërbimet e munguara, si LTE dhe CAMEL, në disa partnerë roaming.

Të hyrat neto nga roaming inbound (vizitorët në rrjetin Vala) në vitin 2024 ndjekin trendin e rritjes. Kontribuuesit kryesorë janë partnerët rajonalë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, si dhe operatorë nga vende si SHBA, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria, etj.

Nga ana tjetër, shpenzimet neto për roaming outbound kanë shënuar një rritje të ndjeshme, ndryshe nga pritet dhe trendi i viteve të kaluara, duke u rritur nga 650 mijë në 1.16 milionë euro. Rritjet më të mëdha vijnë nga partnerët me të cilët nuk kemi tarifa të negociuara dhe ku ka pasur konsum të ulët, por me tarifa të larta.

Me përmirësimet në rrjet dhe një qasje më proaktive në negocimin e tarifave, pritet që të ketë efekt pozitiv në të ardhmen. Ndërkohë, rritja e vëllimit të trafikut ka sjellë një shtim të pritshëm të kostove, ku vetëm trafiku i të dhënave është rritur me 47%.

ii. Shërbimet fikse

Sa i përket infrastrukturës së Telekomit të Kosovës për shërbimet fikse, shërbimet e konsumatorëve ofrohen nëpërmjet rrjetit qendror dhe qasës në gjatësi mbi 1000 km me optikë (kapacitete transportuese, rrjeta FTTH dhe FTTN).

d. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2024

Përkundër vështirësive dhe gjendjes jo të mirë të trashëguar viteve të fundit, si rezultat i marrjes së një varg masash për rritjen e të hyrave, investimet në teknologji, modifikimi i pakove, dhe reduktimi i të gjitha kategorive të shpenzimeve, edhe në vitin 2024 ka vazhduar trendi pozitiv i përmirësimit të performancës financiare dhe forcimit të stabilitetit të kompanisë.

Përkundër faktit që gjatë vitit 2024 kemi pasur dy herë bllokim të llogarive nga përmbaruesi, që lidhen me borxhe që rrjedhin nga kontestet gjyqësore (me vlerë rreth 20 milionë €), kompania ka arritur që më shumë vështirësi të vazhdojë operimin dhe të paguajë detyrimet kryesore financiare që lidhen me operimet (pagat, qiratë, ARKEP, energjinë elektrike dhe furnitorët tjera).

Të hyrat totale

Në vitin 2024 janë realizuar të hyra totale në vlerë prej 59,293k Euro, që krahasuar me planin e buxhetit 2024, këto të hyra janë për 1.06% më të ulëta ose për 636k Euro më pak se të hyrat e planifikuara prej 59,929k Euro. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të hyrat e përgjithshme aktuale janë për 4.36% më të larta ose për 2,478k Euro më shumë se të hyrat e realizuara në vitin 2023 në vlerë prej 56,814k Euro.




Figura 1 Proporcion i të hyrave të përgjithshme i paraqitur në përqindje (%)

Proporcion i të hyrave të përgjithshme të gjeneruara për vitin 2024, në mes të shërbimeve mobile dhe shërbimeve fikse, i shprehur në përqindje (%) paraqitet me rreth 87% me 13% në të mirë të të hyrave mobile.

Në vitin 2023, struktura e këtyre shërbimeve ne krahasim me vitin 2024, ishte 88% me 12%, në të mirë të shërbimeve mobile.




Figura 2 Rezultati i performancës financiare në vitin 2024

e. Progresi me Planin e Biznesit

Krahasuar me buxhetin e vitit 2024, kompania ka arritur që të jetë përafërsisht brenda parametrave sa i përket të hyrave, duke realizuar 98.94% të të hyrave të planikuara, përkatësisht janë realizuar 59,293k Euro nga 59,929k Euro sa ishin planifikuar për 2024. Ndërsa krahasuar me vitin e kaluar të hyrat aktuale 2024 janë realizuar në masën 104.36% ose 4.36% më të larta nga 56,814k Euro sa ishin realizuar në vitin 2023.

Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në masën prej 97.79% krahasuar me shpenzimet e planikuara., ndërsa janë tejkaluar për 5.20% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të cilat ishin realizuar në vlerë prej 49,654k Euro.

Sipas planit të biznesit 2024, ishte parashikuar që kompania të operojë me fitim në vlerë prej 6,511k euro, por për shkak të uljes së shpenzimeve dhe performancës pozitive, kompania në fund të vitit 2024, ka operuar me fitim në vlerë prej 6,808k Euro.




Figura 3 Rezultatet e përfomancës financiare - krahasimi me vitet paraprak

Në grafik është bërë krahasimi me vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe rezultati i vitit 2024 (A- arritur) si dhe buxheti për vitin 2024 (B-buxhet i planifikuar).

f. Shpenzimet kapitale dhe projekte

Telekomi i Kosovës ka vazhduar orientimin në realizimin e projekteve kapitale për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në drejtim të një rrjete të integruar telekomunikuese. Kjo infrastrukturë telekomunikuese ofron mundësitë për shërbime konvergjente si dhe zgjeron mundësitë për një portfolio të shërbimeve që plotëson nevojat aktuale të konsumatorëve.

Aktivitetet e limituara operative kanë qenë të orientuara në riinxhinderimin e rrjetit mobil të SB-ve, për të siguruar optimizim të rrjetit të qasjes (pjesa mobile) dhe "Zgjerimi i rrjetit pasiv" & "Zgjerimet e rrjetit të qasjes – Pajisjet aktive" (pjesa fikse e infrastrukturës), si dhe ne ndërlidhjen e SB-ve me infrastrukturë optike.

Investimet kapitale, gjatë vitit 2024, janë fokusuar në intensifikimin e procedurave të nevojshme dhe krijimin e kushteve për realizimin e projekteve kryesore si më poshtë:

1. Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil
2. Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese në tërë territorin e Kosovës
3. Furnizim me pajisje aktive për rrjeta optike
4. Projekti i Ekonomisë Digitale për Kosovën (KODE)

Investimet e tjera në projekte kapitale përfshijnë avancime të platformave ekzistuese të TK-së, ku me theks të veçantë është integrimi i platformave që mbështesin proceset kyçe të biznesit në TK dhe të platformave të faturimit. Ky integrim mundëson automatizimin e proceseve të punës dhe konvergjencën e shërbimeve mobile dhe fikse.

g. Perspektiva për të ardhmen

Indikatorët dhe projekcionet tregojnë se përmirësimi i gjendjes financiare do të vazhdojë edhe në vitin 2025, duke u mbështetur në rritjen e të hyrave, implementimin e projekteve investuese për shërbime më të mira dhe reduktimin e shpenzimeve. Financimi përmes kredive afatgjata do të ndihmojë në menaxhimin e likuiditetit.

Për krahja financiare vazhdon të mundësojë realizimin e objektivave strategjike për periudhën 2024-2026, duke përfshirë zhvillimin e shërbimeve telekomunikuese të teknologjisë së re. Ristrukturimi do të përmirësojë koordinimin e departamenteve.

Konsolidimi i konsumatorëve dhe përmirësimi i Brendit përmes cilësisë dhe komunikimit më të mirë do të rrisin ARPU-në dhe të ardhurat. Implementimi i projekteve për modernizimin e rrjetit telekomunikues dhe zgjerimin e shërbimeve mobile 5G do të sjellë rritje të konsumatorëve dhe do të mundësojë shërbime më të avancuara.

Telekomi synon:

- Rritjen e ARPU-së.
- Rritjen e bazës së konsumatorëve përmes pakove PrePaid dhe Postpaid.
- Përmirësimin e imazhit të Brendit dhe shërbimit ndaj konsumatorëve përmes kampanjave dhe përmirësimit të përvojës.

Këto objektiva lidhen ngushtësisht me investimet në platformat teknologjike dhe rrjetet telekomunikuese, që do të përmirësojnë shërbimet dhe kënaqshmërinë e konsumatorëve.

h. Kalendari financiar

Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin
2024 nga Auditorët e Jashtëm duhet të
prezantohet deri më datë: **30.06. 2025**

Figurat e pasqyruara në këtë raport për vitin
2024 paraqesin rezultatet preliminare të
paaudituara.

Bazuar në kalendarin e pasqyruar më lart, raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Pasqyrat Financiare të Audituara pritet të publikohen deri më **30.06 2025**. Telekomi i Kosovës është në proces të auditimit të Pasqyrave Financiare nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit për periudhën Janar-Dhjetor 2024, dhe pritet që brenda afatit ligjor të finalizohen Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit.

VIII. Shtojca

a. Statuti i TK-së

(bashkëngjitur si pdf)

b. Pasqyrat financiare preliminare për vitin 2024

(bashkëngjitur si pdf)

c. Sponsorizimet dhe donacionet

(Për shkak të gjendjes jo të mirë financiare, Korporata nuk ka mbështetur kërkesat për sponsorizime dhe donacione)

d. Raportimet sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike

- i. Pasqyra e strukturës organizative
- ii. Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare gjatë vitit përkatës (kjo pjesë është e plotësuar në kuadër të raportit)
- iii. Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruara ose të kërcënua, ose që mund të përfshijnë NP
- iv. Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse
- v. Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsyen pritet që ta rrisin performancën e NP-së (kjo pjesë është e plotësuar në kuadër të raportit)

i. Pasqyrat e strukturës organizative

Pasqyrat e strukturës organizative, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë vitit përkatës

Struktura organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A




Figura 4 Struktura e re organizative

PAQYRA E NDRYSHIMEVE: Janar - Dhjetor 2024

Gjatë vitit 2023, ka filluar implementimi i procesit të ristrukturimit përkatësisht kalimi nga struktura e mëhershme. Ky implementim po vazhdon edhe në periudhën raportuese. I tërë procesi planifikohet të përfundojë deri më 30.05.2025.

Gjatë periudhës reportuese të vitit 2024 janë shpallur gjithsej 136 konkurse të brendshme.

ii. Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare gjatë vitit 2024

(kjo pjesë është plotësuar në kuadër të këtij raporti)

iii. Përbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit, të pambaruara ose të kërcënua, ose që mund të përfshijnë korporatën

Gjatë vitit 2024, Departamenti Ligjor i TK Sh.A ka pasur në punë aktive gjithsej 921 lëndë gjyqësore të natyrave të ndryshme,

- Konteste të punës 706 lëndë;
- Konteste të ndryshme 93 lëndë;
- Lëndë në të cilat TK është palë paditëse janë 123 lëndë;
- TK si palë debitor ka pranuar 16 raste, përmbarimore (urdhër përmbarimi);
- TK si palë kreditore ka dërguar në përmbarim 601 raste, nga Telefonia Mobile dhe Fikse.

Gjatë vitit 2024, Departamenti Ligjor i TK Sh.A, pranë përmbaruesve privatë dhe gjykatave kompetente në tërë territorin e Republikës së Kosovës ka dërguar/realizuar si në vijim:

Telefonia Fikse me shërbime:

1. Gjatë vitit 2024, raste të dërguara në procedurën përmbarimore tek përmbaruesit privatë për shërbimet e ofruara të telefonisë fikse, janë gjithsejtë 418 lëndë.
2. Nga Gjykatat Themelore të Kosovës gjatë vitit 2024, janë përfunduar gjithsejtë 747 lëndë.
3. Nga Përmbaruesit Privat, gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 288 raste.
4. Në total, nga gjykatat dhe përmbaruesit privatë, gjate vitit 2024 janë realizuar gjithsej 1035 lëndë.

Telefonia mobile

1. Gjatë periudhës së vitit 2024, raste të dërguara në procedurën përmbarimore te përmbaruesit privatë, për shërbimet e ofruara të telefonisë mobile, janë 183 raste.
2. Nga Gjykatat Themelore të Kosovës gjatë periudhës së vitit 2024, janë përfunduar gjithsej 298 lëndë.
3. Nga Përmbaruesit Privatë, gjatë periudhës 2024, janë realizuar gjithsej 196 raste.
4. Në total, nga gjykatat dhe përmbaruesit privatë, gjatë periudhës 2024, janë gjithsej 494 lëndë.

Me synimin e ngritisës së efikasitetit të gjykatave në lëmin e lëndëve përmbarimore, gjatë vitit 2024 janë kryer shumë urgjenca dhe komunikime me gjykatat kompetente dhe zyrat përmbarimore, me qëllim të sensibilizimit të veprimit të tyre sipas lëndëve të grumbulluara që presin veprim.

Janë ushtruar, përpos propozim-përmbarimeve edhe padive për kompensim dëmi, të cilin dëm e kanë shkaktuar qytetarët apo subjektet tjera biznesore, korporatës, si dhe janë ushtruar shumë parashtresa, ankesa dhe mjete tjera juridike, si ato të rregullta ashtu edhe ato të jashtëzakonshme, si ankesa kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë, dhe revizione kundër aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së dytë. Gjithashtu, janë hapur edhe konteste administrative kundër vendimeve të Kuvendeve Komunale për procedurat administrative që

janë zhvilluar nga ana e tyre, si dhe kundër vendimeve të Inspektorateve të Punës, me objekt kontesti-konflikti administrativ.

Në rastet e aktgjykimeve aprovuese/ngarkuese ndaj korporatës, janë ushtruar dhe parashtesa të shumta, mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme si ankesa kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë, dhe revizione ndaj aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së dytë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjatë vitit reportues janë arritur shumë marrëveshje jashtëgjyqësore për pagesa të obligimeve financiare të korporatës ndaj kreditorëve (kontraktorëve dhe të punësuarve), është eliminuar mundësia që korporata t'i nënshtrohet kamatave dhe shpenzimeve procedurale dhe është menaxhuar pagesa në tërësi konform mundësive financiare të korporatës.

Përfaqësimet në gjykata të rregullta dhe procedurat përmbarimore janë realizuar në afate optimale dhe nuk ka pasur asnjë mungesë të përfaqësimit në gjykatë të interesave të korporatës.

iv. Transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse

Të dhënat në reportin e mëposhtëm përfshijnë të gjitha kontratat e rëndësishme (për vlerat e parashikuara mbi 1.000 euro) të nënshkruara gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024

Nr.	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës	Emri i OE të cilil i është dhënë kontrata
1	Larja dhe pastrimi i automjeteve zyrtare te Telekomit te Kosovës	4.1.2024	2,800.00	2,360.00	PRICLEAN L.L.C.
2	Furnizim me material elektrik për mirembajtje dhe instalim te BTS-ve	5.1.2024	9,950.00	5,827.86	ELEKTRO - AB SH.P.K.
3	Konsulentë individual për shërbime të veçanta juridike	5.1.2024	17,760.00	16,992.00	Lulzim Sokoli
4	Furnizim me kanale televizive të Digitalb	22.1.2024	1,300,000.00	1,300,000.00	Digitalb sh.a
5	Rregullimi dhe riparimi i boshtit të trapit për Kamion IVEKO.	19.1.2024	2,010.00	2,000.01	Ramadan Raçi B.I.
6	Furnizim me Stacione Bazë (SB) për modernizim të rrjetit radio	19.1.2024	15,000,000.00	15,000,000.00	Ericsson Nikola Tesla d.d.
7	Kontrollimi dhe Servisimi i Aparateve kundër Zjarrit dhe Shqyrtimi i Hidrantëve për fikjen e zjarrit	22.1.2024	15,340.00	12,756.80	PROGLOBAL SH.P.K.
8	Mirëmbajtje dyvjeçare (2), avancimet dhe migrimi në platformën e re të App Vala jonë	22.1.2024	22,000.00	21,905.63	PBC SH.P.K.
9	Furnizim me Hard Disk për Serverët e Platformave IPTV, HNM dhe HP	24.1.2024	6,000.00	5,620.00	InterAdria L.L.C.
10	Furnizim me kompresor për klimatizimin industrial të modeleve për Server Room	1.2.2024	16,500.00	16,626.20	VOLTRUN ENG SH.P.K.
11	Vazhdimi i licencës për Bitdefender GravityZone Business Security Enterprise	5.2.2024	62,000.00	54,280.00	CISTCK L.L.C.
12	Furnizim me pajisje për testimin e rrjetit mobil	20.2.2024	80,000.00	79,667.07	JOLIX SH.P.K.
13	Plotësime funksionale ne CRM	21.2.2024	14,750.00	14,750.00	VERSO ALTIMA D.O.O.-BRANCH IN KOSOVO
14	Kontrollimi teknik për automjete	21.2.2024	4,500.00	4,500.00	ECO - ENG SH.P.K.
15	Furnizim me pjese rezervë të IT-se – SSD dhe pajisje IT	4.3.2024	7,531.00	6,637.86	Offishop Group SH.P.K.
16	Furnizim me rrollne për printer fiskal	5.3.2024	3,750.00	2,227.84	MEDIATECH & PRINT SH.P.K.
17	Shërbime shtesë të përfaqësimit ligjor pranë Gjykatës Supreme Federale të Zvicrës	11.3.2024	53,000.00	53,000.00	Baker McKenzie Diwok Hermann Petsche Rechtsanwälte LLP & Co KG
18	Sigurimi i Auto përgjegjësisë Grupi tarifor I cm3, Automjete për pasagjerë	14.3.2024	11,045.37	11,045.34	K.S. Dukagjini SH.A.
19	Sigurimi i Autopërgjegjësisë Grupi tarifor II Ton, Automjetet Kargo – Kamionët	14.3.2024	16,679.30	16,679.30	K.S. Dukagjini SH.A.

20	Sigurimi i Autopërgjegjësisë Grupi Tarifor III Ton, Rimorkiot	14.3.2024	118.79	118.78	KOMPANIA E SIGURIMEVE "ILYRIA" SH.A
21	Furnizimi dhe montimi me Pajisje Terminale TAS (Time Attendance Sistem).	19.3.2024	19,540.00	18,667.60	PBC SH.P.K.
22	Furnizimi me pajisje për kontroll të qasjes (Access Control), dhe riparim të sistemit ekzistues SOYAL.	19.3.2024	7,702.00	6,913.62	ELEKTRA L.L.C.
23	Furnizim me Profile UNP 120	22.3.2024	27,286.32	19,971.26	A & B engineering SH.P.K.
24	Furnizim me piye dhe artikuj tjerë	25.3.2024	1,300.00	766.41	Dauti Komerc SH.P.K.
25	Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio	2.4.2024	116,440.00	71,300.00	Q.M. "Tema"
26	Materiale shpenzuese të përgjithshme	14.5.2024	11,655.00	9,961.95	Ideal Shala B.I.
27	Pjesë këmbimi për Kamionetë IVECO	13.5.2024	8,557.00	9,415.00	VISTATECH AIR SH.P.K.
28	Pjesë këmbimi për "MITSUBISHI OUTLANDER	13.5.2024	13,952.00	10,317.00	VISTATECH AIR SH.P.K.
29	Pjesë këmbimi për NISSAN TERRANO	15.5.2024	2,869.00	2,722.00	PROAKTIV ONE L.L.C.
30	Furnizim me garacion dhe përkrahje tekniqe(Tech Care Essential) te HP 3PAR 8440 SAN	24.5.2024	37,760.00	32,124.18	InterAdria L.L.C.
31	Furnizim me Switcha për rrjetin e brendshëm	6.6.2024	6,000.00	4,801.90	CLASTERTECH SH.P.K.
32	Upgrade i Sistemit të Billingut Postpaid	20.6.2024	180,000.00	180,000.00	Integratouch LLC
33	Furnizim me material shpenzues (INK CARTRIDGES për Ploter)	27.6.2024	2,200.00	1,957.90	Comtrade Computers O.K.
34	Furnizim me HD (Hard disk) për storage te platformës ISP	10.7.2024	5,000.00	1,815.05	Safebit L.L.C.
35	Furnizim me TV për Platformën e Monitorimit 24/7 ne kuadër të Njësisë Qendra e Operimit të Rrjetit	11.7.2024	2,000.00	1,951.72	Pattern SH.P.K.
36	Furnizimi me artikuj shtesë të prodhuesit Ericsson për modernizim të rrjetit radio mobil	12.7.2024	98,500.00	88,154.02	Ericsson Nikola Tesla d.d.
37	Furnizim me Vegla Pune	26.7.2024	1,400.00	1,604.80	" FOTEK " SH.P.K.
38	Furnizim me Klima Split Sistem për dhomat e pajisjeve telekomunikuese	31.7.2024	9,950.00	7,129.56	Adnani group SH.P.K.
39	Furnizimi me artikuj shtesë të prodhuesit Ericsson për modernizim të rrjetit radio mobil	1.8.2024	9,900.00	6,956.10	" Ballkan Petrol " SH.P.K.
40	Furnizim me material për zyre.	1.8.2024	19,900.00	14,892.19	Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.
41	Furnizimi me artikuj shtesë të prodhuesit Ericsson për modernizim të rrjetit radio mobil	5.8.2024	1,950.00	1,947.71	N.N.SH. A & E COM
42	Migrimi i platformës BSS-CRM në Harduer të ri	14.8.2024	190,000.00	204,730.00	VERSO ALTIMA D.O.O.-BRANCH IN KOSOVO

43	Furnizim me pjese rezerve te IT-se - SSD dhe pajisje IT	16.8.2024	7,581.00	5,942.53	" FutureBITS " SH.P.K.
44	Furnizim me Smart Box për shërbimet televizive përmes teknologjisë OTT	19.8.2024	750,000.00	715,198.00	Botek shpk
45	Riparim (servisim) i pajisjeve Fusion Splicer	22.8.2024	2,900.00	2,914.60	" FOTEK " SH.P.K.
46	Përfaqësimi Juridike dhe Konsulencë juridike	22.8.2024	21,600.00	19,824.00	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.
47	Riparimi montimi Power Pack (driver) të ashensorit OTIS	29.8.2024	2,950.00	2,950.00	INTERNATIONAL ELEVATOR COMPANY SH.P.K.
48	Furnizimi me Material dhe Pajisje për mirëmbajtje operative të objekteve te TK Sh.A	9.9.2024	3,874.80	4,648.61	ALY Group SH.P.K.
49	Furnizim me pjesë rezervë për nevoja të gjeneratorëve të Deutz	5.9.2024	15,000.00	13,373.92	" Trade Fix Zone " SH.P.K
50	Furnizim me pjesë rezervë për nevoja të gjeneratorëve të Perkins	9.9.2024	28,000.00	16,897.60	Ramadan Raçi B.I.
51	Furnizim me pjesë rezervë për nevoja të gjeneratorëve te Lister- Petter	9.9.2024	42,000.00	32,868.90	Ramadan Raçi B.I.
52	Furnizim me pjesë këmbimi për automjete IVECO	11.9.2024	8,557.00	7,662.00	EURORICAMBI - 1 SH.P.K.
53	Furnizim me pjesë këmbimi për automjete Mitsubishi & Kia	12.9.2024	13,982.00	11,989.50	Kadiu
54	Mirëmbajtja e platformës SMSC ne ISP storage	18.9.2024	69,000.00	73,000.00	KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.
55	Furnizim me pllaka të riparuara për mirëmbajtje dhe zgjerim të unazës IP MPLS 7450 ESS	20.9.2024	25,000.00	35,500.30	Bahri Asllani
56	Furnizimi dhe montimi i baterive industriale për UPS	2.10.2024	70,000.00	67,260.00	EXBATT GROUP SH.P.K.
57	Furnizimi dhe montimi i pjesëve për klimën industriale STULZ ne NGN- Prishtine	3.10.2024	3,000.00	2,938.20	InterAdria L.L.C.
58	Furnizim me LTO Ultrium 8 Data Cartridge 12TB Native 30TB Compressed Part	9.10.2024	4,500.00	3,586.68	Pattern SH.P.K.
59	Shërbime të Dezinfektimit Dezinsektimit dhe Deratizimit DDD	18.10.2024	14,345.00	6,770.84	S.V.,,Veterina
60	Furnizim me fletushka broshura reklama me madhësi dhe dizajne te ndryshme	24.10.2024	9,983.00	5,310.00	EUROPRINT GROUP SH.P.K.
61	Blerja e përmbajtjes së IPTV-se nga TRING TV	24.10.2024	720,000.00	900,000.00	TRING TV SH.A.
62	Furnizim me Licencë për Windows Server 2019 Standard Edition	24.10.2024	1,500.00	1,282.97	Infosoft Systems SH.P.K.
63	Furnizim dhe montim me klima split-sistem për centralet e Telekomit të Kosovës	25.10.2024	9,950.00	7,811.60	ECO SMART ENGINEERING SH.P.K.

64	Punë tipike civile për infrastrukturën telekomunikuese në Regionin e Prishtinës	1.11.2024	30,000.00	28,515.00	INLINE ENGINEERING SH.P.K.
65	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 1- Prishtina (Qyteti)	15.11.2024	2,400,000.00	1,912,225.78	UKAB SH.P.K.
66	Pjesa Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - LOT 7- Mitrovica	15.11.2024	1,700,000.00	1,354,826.08	UKAB SH.P.K.
67	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 3- Prizreni	25.11.2024	2,100,000.00	1,610,491.10	KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.
68	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 2- Prishtina (Regioni)	11.11.2024	2,200,000.00	1,576,995.22	" KOSPROD " SH.P.K.
69	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 4- Ferizaj	11.11.2024	1,750,000.00	1,334,944.87	" KOSPROD " SH.P.K.
70	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 6- Peja	8.11.2024	1,700,000.00	1,577,136.01	Grup i Operatorëve Ekonomik IDK KONSTRUKSION SHPK; TSR SH.P.K.
71	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetave telekomunikuese optike në tërë territorin e Kosovës - Pjesa LOT 8- Gjakova	8.11.2024	1,400,000.00	1,257,874.57	Grup i Operatorëve Ekonomik IDK KONSTRUKSION SHPK; TSR SH.P.K.
72	Furnizimi dhe montimi i sporteleve	12.11.2024	11,600.00	8,437.00	IBM SH.P.K.
73	Furnizimi me sirtarë dhe dollapë	12.11.2024	1,915.00	1,469.10	IBM SH.P.K.
74	Furnizim me karrige levizese	11.11.2024	2,400.00	1,839.62	" INFINITT " SH.P.K.
75	Furnizim me IP kapacitet në pikën e caktuar	22.11.2024	50,000.00	46,428.00	Makedonski Telekom AD Skopje
76	Furnizim me IP Kapacitet në pikën alternative	8.11.2024	50,000.00	49,599.93	" TelKos " L.L.C.
77	Rollne për printer fiskal	6.12.2024	2,200.00	1,971.66	Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.
78	Furnizimi me mbajtëse për broshura në pikat e shitjes - Vala	6.12.2024	3,400.00	2,973.60	Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.
79	Furnizim me material promovues çadër-ombrellë me logo Vala	10.12.2024	15,000.00	14,018.40	Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.
80	Mirëmbajtja e Platformës së Billingut POSTPAID-SYMPHONY	13.12.2024	100,000.00	100,000.00	Integratouch LLC
81	Furnizim me material për pastrim	31.12.2024	16,368.00	11,765.78	Shaip Mustafa B.I.
82	Furnizim me material shpenzues	31.12.2024	7,866.00	5,546.59	Shaip Mustafa B.I.
83	Furnizim me mjete pune per pastrim	31.12.2024	3,580.00	4,984.32	N.N.SH. A & E COM
TOTALI I PËRGJITHSHËM			32,787,647.58	30,164,867.54	

Tabela 4. Transaksionet e konsiderueshme